



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
OIK



**Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës**  
**Komora medicinskoh sestrara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova**  
**The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals**

Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1.3 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor Nr.04/L-150, nenit 14 paragrafi 1.3, nenit 26 të Statutit të Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësorë, dhe vendimit të Këshillit Drejtues, me date 08.03.2024 nxjerrë këtë:

## VENDIM

### Për kriteret dhe procedurat e provimit profesional të Ri licencimit

1. Të drejtë për hyrje në provim kanë kandidatët të cilëve i ka skaduar afati i licencës në periudhë prej jo më shumë se 60 ditësh para skadimit të licencës, dhe të cilët nuk kanë arritur kriterin e paraparë të pikëve kredituese për ri licencim.
2. Të gjithë kandidatëve, të cilëve iu ka skaduar afati i licencës më shumë se 6 muaj nga data e skadimit, pa marrë parasysh sigurimin e pikëve kredituese, obligohen të ju nënshtrohen provimit profesional të ri licencimit.
3. Kandidatëve të cilëve iu ka skaduar licenca në afat jo më shumë se 6 muaj kanë të drejtë në ri licencim duke iu valorizuar pikët kredituese të fituara në afatin kohor 6 muaj nga data e skadimit.
4. Kandidatët të cilët kanë fituar së paku 50% të pikëve brenda afatit, përfitojnë zbritje të taksës.
5. Të gjithë kandidatët të cilët posedojnë 0-49 pikë kredituese, paguajnë taksën e plotë për provimin profesional të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues me nr. prot 637 të datës 04/05/2023.
6. Të gjithë kandidatët të cilët kanë arritur 50 apo më shumë pikë kredituese, por që nuk kanë arritur kriterin për ri licencim përmes edukimit të vazhdueshëm profesional, paguajnë taksën 50% nga taksa e përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues me nr. Prot 637 të datës 04/05/2023
7. Kandidatët e pa punësuar Anëtarë të OIK, paguajnë taksën 50% nga taksa e përcaktuar me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues. Kandidatët duhet të dëshmojnë përmes vërtetimit nga Trusti Pensional i Kosovës.
8. Kandidatët të cilët arsyetojnë me dëshmi mjekësore mos arrijen e pikëve kredituese për ri licencim, me kërkesë të veçantë i drejtohen Këshillit Drejtues të OIK.
9. Kandidati i cili ka dështuar në njërin nga lëndët e Provimit Profesional të Ri licencimit lirohet nga kjo taksë për Ri provim në atë lëndë, ndërsa kandidati i cili ka dështuar në dy apo më shumë lëndë të provimit profesional të Ri licencimit, obligohet ti nënshtrohet të gjitha provimeve dhe të paguaj taksën e provimit.
10. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me nr. Prot 1290
11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i KD të OIK-ut

Bashkim Mehmeti



Kryetare e OIK-ut

Ma.Nexhmije Gori